Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për

*çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, gjegjësisht në paragrafin II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 të këtij aktgjykimi ka sqaruar: 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë **në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.***

Andaj, duke qenë se Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e nenit 6, paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë vetëm mbi bazën e aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht, pretendimet ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk kanë mbështetje ligjore.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur më pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik, dhe se efektet

e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimit (pra nga data 01.02.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit F.K, M.SH, SH.B, R.H, M.P, M.D, I.K R.K, A.D, E.T, M.B, S.M, Q.B Y.Ç, A.O, G.J.M, L.M, SH.B, N.K, E.Ç-K, A.SH, V.H, A.K, A.G, A.K, SH.K, A.D-S, A.P, S.S-K dhe K.G, *sepse:*

Nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit si në këtë pikë të arsytimit kanë themeluar marrëdhënie pune më kontratë si nëpunës publikë bazuar në Ligjin Nr.03/L-212 të Punës. Rrjedhimisht, Ankuesja, F.K, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Librare në Bibliotekën Ndërkomunale Prizren*; Ankuesja M.SH, sipas Aktit të Emërimit e datës 30.11.2011, ushtron pozitën e punës *Biblotekiste në Bibliotekën Ndërkomunale Prizren*; Ankuesja SH.B, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Biblotekiste në Bibloteken Ndërkomunale Prizren*; Ankuesja R.H, sipas Vendimit të datës 24.08.2010, ushtron pozitën e punës *Librare në Shtëpinë e Kulturës në Gjonaj të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*; Ankuesi M.P, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Biblotekist në Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit*; Ankuesja M.D, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Biblotekiste në Bibloteken Ndërkomunale Prizren*; Ankuesi I.K, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Ekonomist në Biblotekën Ndërkomunale Prizren*. Ankuesja, A.P sipas Kontratës së Punës të datës 11.07.2023, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Bibloteka në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport*; Ankuesja, S.S-K sipas Kontratës së Punës të datës 11.07.2023, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Biblioteka në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport*; Ankuesi, K.G sipas Kontratës së punës të datës 06.11.2020, ushtron pozitën e punës *Financiar në Teatrin e Qytetit në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport*; Ankuesja, R.K sipas Kontratës së punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesja, A.D sipas Kontratës së punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesi, E.T sipas Kontratës së Punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesi, M.B sipas Kontratës së Punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesja, S.M sipas Kontratës së Punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesi, Q.B sipas Kontratës së Punës të datës 21.10.2020, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesi, Y.Ç sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit*; Ankuesja, A.O sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit*; Ankuesi, G.J.M sipas Kontratës së punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit*; Ankuesja, L.M sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Infermier në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale*; Ankuesi, SH.B sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier në Drejtorinë e*

Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesja, N.K sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit; Ankuesja, E.Ç-K sipas Kontratës së Punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesja, A.SH sipas Kontratës së punës të datës 01.04.2021, ushtron pozitën e punës *Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesja, V.H sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 22.05.2024, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesja, A.K sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 22.05.2024, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesi, A.G sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 22.05.2024, ushtron pozitën e punës *Ndihmës Infermier* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesi, A.K sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 02.09.2024, ushtron pozitën e punës *Punëtor Social* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesi, SH.K sipas Kontratës së Punës të datës 21.02.2024, ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i shtëpisë së të moshuarve* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesja, A.D-S sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 02.09.2024, ushtron pozitën e punës *Punëtor Social* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit në pikëpamje lëndore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Kategoritë e zyrtareve publik janë: 1.1. Nëpunës i shërbimit civil; 1.2. Nëpunës i shërbimit publik; 1.3. Krijues dhe përformues i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunës teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtar i kabinetit. 2. Nëpunës i shërbimit civil është zyrtari publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunës i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e drejtuesit të lartë, në administratën e Presidentit të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunësi statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. Nëpunës i shërbimit publik është zyrtari publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, **artit**, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësi i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësi i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e Komunës. Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton fakti së të gjithë të punësuarit duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve nga fusha e kulturës, shëndetësisë si dhe shërbime tjera kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publik.*

Duke u nisur nga konstatimi së ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civilë dhe meqenëse sipas nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton së Këshilli nuk ka kompetenca lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve sipas kësaj pikë të arsyetimit.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji ve theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministritë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimit publik, në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të parashtrojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, duke ju referuar përcaktimeve ligjore sipas nenit 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 79, paragrafi 1** “... 1. I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. **Neni 79 paragrafi 1:** Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”.*

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesit nuk kanë parashtruar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Komunën e Prizrenit.

III. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit I.M, F.G, K.M, A.K, A.K, G.G, I.TH, A.B, N.XH, A.B, R.B, S.K, S.G, M.P, M.M, A.O, S.H, B.K, N.LL, M.G, V.M, L.SH-H, J.M, I.M, M.K, O.O dhe J.K, *sepse*:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se ankuesi, I.M, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Bifeist*; Ankuesi, F.G, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, K.M, sipas Aktit të Emërimit të datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, A.K, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, A.K, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, G.G sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, I.TH, sipas Aktit të Emërimit e datës 04.01.2012, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Administratë. Ankuesi, A.B sipas Kontratës së Punës të datës 07.05.2021, ushtron pozitën e punës *Mirëmbajtës* në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ankuesi, N.XH sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Korrier* në Drejtorinë e Administratës; Ankuesi, A.B sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Korrier* në Drejtorinë e Administratës; Ankuesi, R.B sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës

05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Korrier* në Drejtorinë e Administratës, në Komunën e Prizrenit; Ankuesi, S.K sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Pastrues* në Drejtorinë e Administratës; Ankuesi, S.G sipas Kontratës së Punës të datës 11.11.2022, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Prizrenit; Ankuesi, M.P sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Rojtar* në Drejtorinë e Administratës; Ankuesja, M.M sipas Kontratës së Punës të datës 04.04.2023, ushtron pozitën e punës *Staf Mbështetës* në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport; Ankuesi A.O sipas Kontratës së Punës të datës 01.12.2010, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Shërbime Publike; Ankuesi, S.H sipas Kontratës së Punës të datës 07.08.2020, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, B.K sipas Kontratës së Punës të datës 30.04.2019, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesja, N.LL sipas Kontratës së Punës të datës 22.04.2021, ushtron pozitën e punës *Kuzhinier* në Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Social; Ankuesi, M.G sipas Kontratës së Punës të datës 04.02.2021, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, V.M sipas Kontratës së Punës të datës 01.12.2010, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesja, L.SH-H sipas Kontratës së Punës të datës 04.02.2021, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesja, J.M sipas Kontratës së Punës të datës 30.03.2022, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë; Ankuesi, I.M sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Pastrues* në Drejtorinë e Administratës; ankuesi M.K sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 05.01.2015, ushtron pozitën e punës *Vozitës* në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport; Ankuesi, O.O sipas Kontratës së Punës të datës 30.03.2022, ushtron pozitën e punës *Mbështetës Teknik* në Drejtorinë për Administratë dhe J.K sipas Akt emërimit të datës 08.05.2015, ushtron pozitën e punës *Ekspeditues- Korrier* në Drejtorinë për Administratë.

Kolegji i Këshillit lidhur me statusin e ankuesve si në pikën III të arsyetimit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5, paragrafi 5, ku përcaktohet se: *5.Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*”. Rrjedhimisht, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji konstaton se pozita vozitës, mbështetës, mbështetës teknik, pastrues, kuzhinier, korrier, Staf Mbështetës, kategorizohen si pozita të kategorisë së nëpunësit teknik dhe mbështetës, kështu që, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, atëherë, duke qenë se ankuesit nuk kanë statusin e nëpunësit civil, rrjedhë fakti se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e tyre.

Në kuptim të udhëzimit të palës ankuese lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji vë theksin të neni 8 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se : *Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave, pra, zyrtarët publikë të kategorisë së shërbimit publik dhe të kategorisë administrative mbështetëse,*

në rast të pretendimeve për shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënie e punës, fillimisht mund të përjashtojnë ankesë tek punëdhënësi i cili themelon një Komision të Ankesave në pajtim me kërkesat ligjore, e më pastaj, mund të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës ku shprehimisht thuhet se: **Neni 78 paragrafi 1** “... 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. **Neni 79 paragrafi 1:** Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente...”.

Marre parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesit nuk kanë parashtruar ankesë të brendshme pranë organit të punësimit, atëherë, bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Komunën e Prizrenit.

IV. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit: M.J, P.T, A.Z, SH.K, D.B, L.R, J.B, Z.V, A.V, I.S, M.B, N.D, SH.K, S.B, R.K, A.P, E.M-I, M.TH, K.P, R.K, R.T, A.D, Z.A dhe F.G, *sepse:*

Nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka vërtetuar se Ankuesit M.J sipas Vendimit të datës 03.09.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 02.09.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, P.T sipas Vendimit të datës 08.01.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 20.12.2024, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, A.Z sipas Vendimit të datës 08.08.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 27.08.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, SH.K sipas Vendimit të datës 30.11.2022, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 05.12.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, D.B sipas Vendimit të datës 04.11.2022, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 31.10.2022, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, L.R sipas Vendimit të datës 07.02.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 22.02.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, J.B sipas Vendimit të datës 11.11.2024, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 14.11.2024, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, Z.V sipas Vendimit të datës 05.11.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 12.11.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, A.V sipas Vendimit të datës 12.05.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 09.05.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, I.S sipas Vendimit të datës 21.06.2023, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 30.05.2023, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, M.B sipas Vendimit të datës 26.06.2024, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 25.06.2024, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, N.D sipas Vendimit të datës 23.02.2024, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 16.02.2024, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, SH.K sipas Vendimit të datës 19.10.2023, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 16.10.2023, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, S.B sipas Vendimit të datës 07.07.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 21.07.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankuesit, R.K sipas Vendimit të datës 28.10.2025,

i përfundon marrëdhënia e punës me datë 03.11.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; Ankueses, A.P sipas Vendimit të datës 17.04.2026, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 14.04.2026, për arsye personale-dorëheqjes; Ankueses, E.M-I sipas Vendimit të datës 13.11.2024, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 15.11.2024, për arsye personale/dorëheqjes; Ankueses, M.TH sipas Vendimit të datës 11.10.2024, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 14.10.2024, për arsye personale-dorëheqjes; Ankueses, K.P sipas Vendimit të datës 01.08.2025, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 31.07.2025, për arsye personale/dorëheqjes; Ankuesit, R.K sipas Vendimit të datës 01.11.2024, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 28.11.2024, për arsye personale/dorëheqjes; Ankuesi, R.T sipas Vendimit të datës 19.11.2025, shkarkohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë së Turizimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Ankueses, A.D sipas Vendimit të datës 27.06.2025, i ndërpritet marrëdhënia e punës me datë 30.06.2025, për arsye personale/dorëheqjes; Ankuesit, Z.A sipas Vendimit të datës 07.04.2025, i miratohet kërkesa për pensionim të parakohshëm nga data 04.04.2025; Ankuesit, F.G sipas Vendimit të datës 05.11.2025, i përfundon marrëdhënia e punës me datë 29.11.2025, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;

Rrjedhimisht, në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji fillimisht thekson faktin se ankuesi si në këtë pikë të arsyetimit kanë humbur statusin e nëpunësit civil për shkak të arritjes së moshës së pensionimit apo dorëheqjes nga shërbimi civil, ndaj, duke u bazuar në nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më të cilin përcaktohet se Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, atëherë, duke qenë se ankuesit më rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill nuk kanë statusin e nëpunësit aktiv civil, rrjedhë së Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve të parashtruar më datë 18.02.2026.

Si rrjedhojë, referuar pretendimeve ankimore të parashtruara si në ankesë, rezulton se në rastin konkret kemi të bëjmë më raport juridiko-civil, kështu që, Kolegji lidhur më të drejtën e ankueseve në mjete juridike udhëzon të njëjtit që të drejtën e tyre materiale të pretenduar si në ankesë ta realizoj në kontest civil në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Procedurën Kontestimore.

V. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit I.U dhe F.M, *sepse*:

Nga provat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi I.U sipas Vendimit të datës 05.01.2026, është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe ankuesi F.M sipas Vendimit të datës 14.01.2026, është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në kuptim të kompetencës materiale të Këshillit lidhur me shqyrtimin dhe vendosjen në këtë çështje juridike-administrative përkitazi më ankuesit si në këtë pikë të arsyetimit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 3, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-1 të datës 97 për Zyrat e Publikë, ku përcaktohet: *1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionarët/ët publik si në vijim; ...1.4. të emëruar/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitë e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji...*" dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor funksionarët publik të emëruar nga kryetaret e komunave nuk kanë statusin e nëpunësit civilë dhe si të tillë janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të Ligjit për Zyrat e Publikë.

Duke u nisur nga konstatimi së ankuesit janë të emëruar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit atëherë të njëjtit nuk ka statusin e nëpunësit civil dhe mbi këtë fakt Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e tyre të parashtruar më datë 18.02.2026, kështu që, në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji erdhi në përfundimin se Këshilli nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve.

VI. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se hedhet poshtë ankesa A.nr.179/2026, lidhur me ankuesin F.H, sepse:

Sipas ankesës rezulton së ankesa është parashtruar edhe në emër të F.H, i njëjti sipas dëshmisë së dërguar nga Komuna e Prizrenit, gjegjësisht sipas Vendimit Nr.01-203/01-158095, të datës 05.12.0204, i është përfunduar marrëdhënia e punës në shërbim civil për shkak të vdekjes së tij më datë 28.11.2024, ndërsa, meqenëse ankuesi me datë 28.11.2024 ka vdekur, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës do të bëjë përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesës së ankuesit ashtu siç përcaktohet me nenin 102 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Nëse një person fizik vdes gjatë procedurës administrative të nisur për një çështje kryekëput personale (intuitu personae), organi publik do të mbyllë dosjen dhe do përfundojë procedurën administrative”.***

Përmbledhur si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1,7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.175/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së ankueseve Shoqërisë së Avokateve Klinaku&Associates;
- Organit të punësimit: Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-se.